

L I G J
Nr.8182, datë 23.12.1996

**PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.7609, DATË 22.9.1992 “PËR TARIFAT DOGANORE”
(I NDRYSHUAR)**

Në mbështetje të neneve 13 dhe 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për Dispozitat Kryesore Kushtetuese” me propozimin e Këshillit të Ministrave

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Në ligjin nr.7609, datë 22.9.1992 “Për tarifat doganore” (i ndryshuar) bëhen këto ndryshime:

1. Nivelet e taksave doganore për të cilat bën fjalë shkronja (b) e nenit 3 do të jenë sipas aneksit të këtij ligji.

2. Neni 20/5 riformulohet si më poshtë:

Përfashtimi nga taksat doganore jepet dhe në rastet e mëposhtme:

a) Për mallrat që do importohen për rikonstruksionin e aeroportit të Rinasit, përfashtimi i të cilave është parashikuar në përputhje me ligjin nr.8023, datë 2.11.1995.

b) Për mallrat që importohen nga kontraktuesit dhe nënkontraktuesit në përputhje me ligjin nr.7746, datë 28.7.1993 “Për hidrokarburet”.

c) Për mallrat që importohen nga personat që kanë fituar titullin “Person i Stimuluar” në bazë të ligjit nr.7665, datë 21.1.1993 “Për zhvillimin e zonave me përparësi turizmin”.

ç) Për mjetet lëvizëse të invalidëve që administrohen nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore në bazë të ligjit nr.7889, datë 14.12.1994 “Për Statusin e Invalidit”.

d) Për armatimet, municionet, pjesët dhe plotësuesit e tyre, për instrumente në funksion të armatimit, aparatet dhe pjesët e tyre.

Neni 2

Ligji nr.7936, datë 18.5.1995 “Për disa ndryshime në ligjin nr.7609” datë 22.9.1992 “Për tarifat doganore” (indryshuar me ligje të tjera shfuqizohet).

Neni 3

Ngarkohet Këshilli i Ministrave të botojë ligjin së bashku me aneksin përkatës.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi më 1 janar 1997.

Shpallur me dekretin nr.1694, datë 30.12.1996 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha